



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 15, datë 04.10.2024

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“FLOWER TOWER, STRUKTURË SHËRBIMI, HOTELERI DHE BANIMI ME 25
KATE MBI TOKË DHE 5 KATE NËNTOKË”, ME VENDNDODHJE NË RRUGËN
E “BARIKADAVE”, BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjekteve zhvilluese shoqërive “Xhajs Tirana” sh.p.k, “Kleal- Invest” sh.p.k, si dhe “Ober” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Flower Tower, strukturë shërbimi, hoteleri dhe banimi me 25 kate mbi tokë dhe 5 kate nëntokë”, me vendndodhje në Rrugën e “Barikadave”, Bashkia Tiranë, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Xhajs Tirana” sh.p.k, “Kleal- Invest” sh.p.k dhe “Ober” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë bashkëlidhen këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuar vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Vendimi Nr. 10, datë 02.07.2024 i Këshillit Kombëtar të Territorit, për miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Flower Tower”, me vendndodhje në Rrugën e Barikadave, Bashkia Tiranë, me subjekt zhvillues shoqëritë “Ober” sh.p.k, “Kleal – Invest” sh.p.k dhe “Xhajs Tirana” sh.p.k, shfuqizohet.



Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË


BELINDA BALLUKU



ANËTAR/SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAIDA ROKA



Nënshkruar më datë 19/04/ 2025